

# FËMIJA IM SHKON NË SHKOLLË

INFORMACIONE PËR PRINDËRIT ME  
FËMIJË QË SHKOJNË NË SHKOLLË  
NË BADEN-WÜRTTEMBERG



Albanisch



**H | N** Heilbronn

# PËRMBAJTJA

## SI FUNKSIONON SHKOLLA NË BADEN-WÜRTEMBERG? \_\_\_\_ 3

Sistemi i arsimit në Baden-Württemberg \_\_\_\_\_ 4

Detyrat shkollore \_\_\_\_\_ 6

## CILAT JANË PRITSHMËRITË E SHKOLLËS NGA UNË SI NËNË/BABA DHE NGA FËMIJA IM? \_\_\_\_\_ 7

Pritshmëritë nga fëmijët \_\_\_\_\_ 8

Pritshmëritë nga prindërit \_\_\_\_\_ 8

Takimet me prindërit \_\_\_\_\_ 9

Festat fetare \_\_\_\_\_ 9

Sëmundje \_\_\_\_\_ 10

## SI MUND TA MBËSHTES FËMIJËN TIM NË SHKOLLË? \_\_\_\_\_ 11

Mbështetja e fëmijës \_\_\_\_\_ 12

Detyrat e prindërve \_\_\_\_\_ 12

Materialet shkollore \_\_\_\_\_ 12

I jepni bukën e pushimit me vete \_\_\_\_\_ 12

Ndihmë me detyrat e shtëpisë \_\_\_\_\_ 14


Këshilla të mëtejshme \_\_\_\_\_ 15



# SI FUNKSIONON SHKOLLA NË BADEN- WÜRTTEMBERG?




# SISTEMI I ARSIMIMIT NË BADEN-WÜRTTEMBERG



## Parimi i sistemit shkollor:

Pas mbarimit me sukses të shkollës, mund të ndiqen shkolla te tjera pasuese, për të arritur një kualifikim të lartë arsimor.



*(Bazuar në pasqyrën e rajonit arsimor të rrethit të Ludwigsburg)*

## DETYRAT SHKOLLORE

Prindërit janë përgjegjës për të siguruar që fëmija të shkojë në shkollë.

- > Fëmija duhet të arrijë në shkollë në orar për çdo ditë shkollore.
- > Duhet të marrë pjesë në çdo event shkollor të detyrueshëm si p.sh.: ekskursione, shëtitje, vizita në teatër, mësimet noti.
- > Në rastet kur fëmija është i sëmurë: Shkolla duhet të njoftohet në po të njëjtën ditë. Shkolla ka nevojë për një letër ndjese me shkrim jo më vonë se 3 ditë.
- > Pushimet nuk duhet të fillojnë më herët apo të zgjasin më shumë. Për festat e rëndësishme fetare (si p.sh. Bajrami i Madh, Kurban Bajrami) prindërit mund të kërkojnë leje të veçantë nga shkolla.



# CILAT JANË PRITSHMËRITË E SHKOLLËS NGA UNË SI NËNË/BABA DHE NGA FËMIJA IM?



## PRITSHMËRITË NGA FËMIJËT

Nga fëmijët ne presim që ata ...

- > të marrin pjesë në mësim dhe të aktivizohen.
- > të mos shqetësojnë të tjerët.
- > të ndjekin mësuesin/mësuesen.
- > të bëjnë pyetje.
- > të bëjnë detyrat e shtëpisë.

Nuk lejohet përdorimi i telefonit celular në shkollë.

## PRITSHMËRITË NGA PRINDËRIT

Prindërit dhe shkolla bashkëpunojnë për suksesin e fëmijës në shkollë. Shkolla kërkon të ketë rregullisht kontakt me prindërit. Prindërit ...

- > janë partnerë të barabartë për shkollën.
- > zhvillojnë biseda prindërore me mësuesit.
- > marrin pjesë në takimet me prindërit.





## TAKIMËT ME PRINDËRIT

Takimet me prindërit zhvillohen në mbrëmje, 2 herë çdo vit shkollor. Mësuesi, mësuesja ose përfaqësuesi i prindërve ju fton në takim. Pritet pjesëmarrja juaj. Prindërit informohen për takime të rëndësishme, për paratë e fondit të klasës dhe pyesin e përgjigjen. Gjithashtu zgjidhen përfaqësuesit e prindërve për klasën (zakonisht 2 persona).

**Në raste se keni vështirësi me gjuhën, shkolla mund të kërkojë përkthyes vullnetar pa pagesë për prindërit. Ju lutem njoftoni mësuesin/ mësuesen nëse kjo është dëshira juaj.**

## FESTAT FETARE

- > Shumica e fëmijëve të lindur në qytetin dhe rrethin e Heilbronn janë katolikë ose protestantë.
- > Shumë prindër i përkasin fesë së krishterë, por nuk janë më aktivë në kishë.
- > Zakonisht në shkollë festohen festat dhe traditat e krishtera si pashkët, viti i ri, krishtlindjet.
- > Si rregull, festojnë të gjithë fëmijët.
- > Shumë festa fetare kanë marrë një karakter botëror (pashkët me lepurin e pashkëve, krishtlindjet me plakun e vitit të ri).

Për festat e mëdha të besimeve të tjera fetare, prindërit mund të kërkojnë leje të veçantë nga shkolla.



# SËMUNDJE

Nëse fëmija juaj është i sëmurë dhe nuk mund të vijë në shkollë, duhet ta raportoni me gojë/me telefon përpara fillimit të orarit të shkollës. Për më tepër, një raport me shkrim i sëmundjes duhet t'i paraqitet shkollës jo më vonë se tre ditë pas raportit oral (shiko modelin).

Nëse fëmija juaj nuk mund të marrë pjesë në edukimin fizik, kërkohet gjithashtu një arsye.

Datum: \_\_\_\_\_

## ENTSCULDIGUNG

Wegen Krankheit konnte mein Kind

\_\_\_\_\_ ,

Klasse \_\_\_\_\_ , vom \_\_\_\_\_ bis \_\_\_\_\_ (Datum)

die Schule nicht besuchen.

Ich bitte, ihr/sein Fernbleiben zu entschuldigen.

\_\_\_\_\_  
(Unterschrift)

# SI MUND TA MBËSHTES FËMIJËN TIM NË SHKOLLË?



# MBËSHTETJA E FËMIJËS

## DETYRAT E PRINDËRVE

---

Prindërit ...

- > mundësojnë mjetet e nevojshme shkollore.
- > i japin fëmijës bukën e pushimit me vete (Vesper).
- > kujdesen që të bëjnë detyrat e shtëpisë.
- > kontrollojnë çantat e shkollës.
- > kujdesen që fëmija të silltet mirë në shkollë dhe promovojnë aftësitë e nevojshme të fëmijës.

## I JEPNI BUKËN E PUSHIMIT ME VETE

---

Orari i fëmijëve përfshin një pushim mëngjesi. I jepni fëmijës tuaj ushqim të shëndetshëm çdo ditë.

Kjo përfshin p.sh.:

- > Bukë me mbushje të ndryshme
- > Fruta: Mollë, rrush, mandarina, banane, dardha etj.
- > Perime të prera: Domate, kastravecë, specia, feta karrote etj.
- > Pije: Shishe uji

## MATERIALET SHKOLLORE


---

Në fillim të vitit shkollor, një listë e materialeve zakonisht shpërndahet nga mësuesi/mësuesja. Shkolla i kushton shumë rëndësi materialit të duhur.

Në dyqan mund të merrni ndihmë, nëse ju duhet, me përpilimin e materialeve. Materialet që mungojnë duhet të blihen rregullisht (p.sh. fletore).

Librat e shkollës, zakonisht huazohen pa pagesë nga shkolla.





## NDIHMË ME DETYRAT E SHTËPISË

---

Prindërit sigurohen që detyrat e shtëpisë të jenë bërë. Fëmija ka nevojë për një vend të qetë për të bërë detyrat e shtëpisë. Kontrolloni çdo ditë detyrat e ardhshme në fletoren e detyrave të shtëpisë.

Gjithashtu:

- A ka ndonjë mesazh nga mësuesi/ mësuesja në fletoren e detyrave të shtëpisë?
- A duhet të reagoni?

Shumë shkolla ofrojnë ndihmë për detyrat e shtëpisë ose programe studentore këshillimi për të mbështetur fëmijën tuaj. Pyesni në shkollën tuaj.

Herë pas here mund të bëni një bisedë me mësuesin/mësuesen për të pyetur nëse fëmija i bën të gjitha detyrat e shtëpisë. Nëse keni vështirësi me gjuhën, mund ta informoni mësuesin/mësuesen, që të mund të kërkojë një përkthyes vullnetar falas.



# KËSHILLA TË MËTEJSHME

## **Puna sociale në shkollë**

Në shumë shkolla ka punonjës/punonjëse sociale. Fëmijët/të rinjtë, mësuesit/mësueset dhe prindërit mund t'i kontaktojnë në rast se kanë probleme (p.sh. ngacmime, vështirësi në të mësuar etj.).

## **Qendra e këshillimit psikologjik në shkollë**

Këshilla dhe mbështetje për nxënësit/nxënëset, prindërit dhe mësuesit/mësueset për pyetjet dhe problemet që lidhen me shkollën. Këshillat janë pa pagesë, rreptësisht konfidenciale dhe të pavarura nga shkolla!

Nëse dëshironi një takim, ju lutemi kontaktoni:

## **SCHULPSYCHOLOGISCHE BERATUNGSSTELLE**

Cäcilienstraße 56

74072 Heilbronn


Takimet sipas orarit:

Telefon: 07131 64-37762

E-mail: [spbs@ssa-hn.kv.bwl.de](mailto:spbs@ssa-hn.kv.bwl.de)

## **Mirë që e di**

Familjet me vështirësi financiare mund të marrin ndihmë financiare shtesë nga federata dhe paketa e pjesëmarrjes (BuT). Informacione të mëtejshme mund të merrni pranë shkollës tuaj.



## PRINTIMI

### Rrethi Heilbronn

Landratsamt Heilbronn  
Lerchenstraße 40  
74072 Heilbronn

Amt für Migration und Integration  
Telefon: 07131 994-8470  
E-mail: [integration@landratsamt-heilbronn.de](mailto:integration@landratsamt-heilbronn.de)

**[WWW.LANDKREIS-HEILBRONN.DE](http://WWW.LANDKREIS-HEILBRONN.DE)**

---

### Gyteti Heilbronn

Bildungsbüro  
Marktplatz 11  
74072 Heilbronn  
Telefon: 07131 56-2410  
E-mail: [bildungsbuero@heilbronn.de](mailto:bildungsbuero@heilbronn.de)

Stabsstelle Partizipation und Integration  
Lohtorstraße 27  
74072 Heilbronn  
Telefon: 07131 56-4537  
E-mail: [integration@heilbronn.de](mailto:integration@heilbronn.de)

**[WWW.HEILBRONN.DE](http://WWW.HEILBRONN.DE)**

---

Broshura është version i muajit qershor 2020.

Koncepti & Organizimi: DIE NECKARPRINZEN  
Kommunikation und Design GmbH, Heilbronn

---